



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA FINIQ

KESHILLI

VENDIM

Nr.76 datë 29/12/2020

“Për miratimin e nivelit të pagave e shpërblimeve të punonjësve të bashkisë Finiq e institucioneve të vartësisë dhe të personave të tjerë të zgjedhur ose të emëruar për vitin 2021”.

Në mbështetje të nenit 8,pika 2,dhe nenit 54, shkrojna “ç”,nenit 55,pika 2,të ligjit 139/2015,”Për Vetëqeverisjen Vendore”, ligjit nr. 152/2013,”Për nënpunësin civil”, i ndryshuar,ligjit nr.9936 datë 26/06/2008,” Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 5, shkronja “a” dhe “b” të ligjit nr.10405 datë 24/03/2011,’Për Kopetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve “,VKM-së nr. 165 datë 02/03/2016”Për Grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore për efekt page ,dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar , të nënpunësve civil dhe të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”,ndryshuar me VKM-në nr.117 datë 08/03/2017,si dhe me ndryshimet e bëra në buxhetin e vitit 2020,Drejtoria e Financës i propozon këshillit bashkiak që në mbledhjen e tij të datës **29/12/2020**:

VENDOSI

1-Të miratojë nivelin e pagave për funksionarët,nënpunësit civilë,punonjësitë administrativë të bashkisë Finiq,si dhe punonjësitë e policisë bashkiake sipas lidhjeve nr.1,2 dhe 3, bashkëlidhur këtij vendimi.

2-Të miratojë shpërblimin e anëtarëve të këshillit bashkiak në masë 10% të pagës së Kryetarit të Bashkisë.

3-Të miratojë shpërblimin e kryetarëve të kryesive të fshatrave të bashkisë Finiq në masën 10% të pagës së Administratorit të Njësive Administrative për kryetarët e fshatrave në kufijtë territorial të çdo njësie.

4-Efektet financiare të këtij vendimi fillojnë më 1 Janar 2021 dhe do të përballohen nga buxheti bashkisë i vitit 2021.

5-Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Personelit dhe Burimeve Njerëzore si dhe Drejtoria e Financës.

6-Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit 139/2015, neni 55,pika 6, si dhe pas shprehjes së ligjëshmërisë nga Prefekti i Qarkut Vlorë.

KRYETARI I KESHILLIT



Ziso NASHO

Lidhja nr. 1 – Niveli i pagës për funksionarët dhe nëpunësit civilë në Bashkinë e Finiq

Emertimi	Kategoria	Grupi	Paga e grupit	Vjetërsia në %	Shtesa për pozicion
Kryetar i Bashkise	-----	-----	-----	-----	99 650
Zv/Kryetar i Bashkise	-----	-----	-----	-----	84 100
Sekretar i Këshillit Bashkiak	II	II-b	1	2%	78 320
Administrator i Njesisë Administrative	-----	-----	-----	-----	83 000
Sekretar i Pergjithshem	I	I-b	1	2%	67 800
Drejtor i Kabinetit	II	II-b	1	2%	59 000
Keshilltar i Kryetarit	III	III-a/1	1	2%	47.000
Drejtor Drejtorie	II	II-b	1	2%	59 000
Përgjegjës Sektori	III	III-a/1	1	2%	47 000
Përgjegjës Sektori	III	III-b	1 ose 2	2%	40 800
Sekretar i kryetarit	IV	IV-b	1 ose 2 ose 3	2%	36 000
Specialist; Inspektor	IV	IV-a	1 ose 2 ose 3	2%	34 900

Lidhja nr. 2 – Niveli i pagës për punonjësit administrativ

Emertimi	Klasa	Paga Baze	Shtesa per vjetërsine
Përgjegjës		39 000	1%
Punonjës pa arsim të lartë të niveleve ekzekutive të shërbimit civil		39 000	1%
Kryeinspektor pa arsim të lartë të niveleve ekzekutive të shërbimit		39 000	1%
Specialist, Inspektor , Sekretare, Kujdestare (kontrata pune)		36 000	1%
Magaziniere		39 000	1%
Arkivist, protokoll me shkolle të mesme		30 000	1%
Punonjës shërbimi		30 000	1%
Shofer sipas mjeteve		35 500	1%
Pastruese		31.600	1%

Vo. Shtesa për vjetërsi në punë për Lidhjen nr. 2 të jepet në masën 1% pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe të llogaritet mbi pagën baze të klasës së I.

Lidhja nr. 3 – Niveli i pagës për punonjësit e Policisë Bashkiake

Emertimi	Paga
K/Inspektor	59 000
Punonjës i policisë Bashkiake (polic)	44 000